



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE**

VENDIM

Nr. 371, datë 29.5.2019

PËR

**DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.594,
DATË 9.10.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR EMËRIMIN
E KRYETARIT DHE TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES
TË FONDIT SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr.32/2018, “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në pikën 1, të vendimit nr.594, datë 9.10.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

- a) Për pjesën e mbetur të mandatit, sipas pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr.32/2018:
 - i. Znj. Fjoralba Caka emërohet në vend të Znj. Teuta Vodo, si përfaqësuese nga ministria përgjegjëse për drejtësinë;
 - ii. Z. Kostandin Shkurti emërohet në vend të Znj. Besa Shahini, si përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin;
 - iii. Znj. Kozeta Angjeliu emërohet në vend të Znj. Mimoza Hysa Çuliqi, si përfaqësuese nga ministria përgjegjëse për kulturën.
- b) Pas përfaqësuesit nga ministria përgjegjëse për kulturën bëhet shtesa, si më poshtë vijon:



“iv. Znj. Anila Hyka Smorgrav emërohet si përfaqësuese nga Këshilli Koordinues i Diasporës.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

**MINISTRI I SHTETIT
PËR DIASPORËN**

PANDELI MAJKO